



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 10.05.2023

Nr: 86

Ora: 11:00

VENDIM

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 22, DATË 06.05.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 10.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ gjorbë në masën 3 000 (tre mijë) lekë ndaj zj. Ledina Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; zj. Zerina Bruci, Sekretar i



Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës; z. Ismail Shehu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë; zj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe zj. Risena Xhaja, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

BAZË LIGJORE:

Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë indicie për publikimin e postimeve në “facebook” me përmbajtje elektorale nga 6 (gjashtë) ministri dhe 10 (dhjetë) ministra, për të cilët pretendohet nga denoncuesi se postimet me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të ministrive/ministrave përbëjnë përdorim të burimeve publike. Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet raportit të KRIIK, të datës 24 Prill 2023 “Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 14 Prill- 20 Prill 2023”.
2. Në këtë denoncim pretendohet se në faqet zyrtare “Facebook” të 6 (gjashtë) ministrive dhe 10 (dhjetë) ministrave janë përdorur slogane elektorale, në formën e hashtag (#) në mbështetje të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”.
3. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ ndaj zj. Ledina Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, zj. Zerina Bruçi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, z. Ismail Shehu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, zj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; zj. Risena Xhaja, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, zj. Viola Haxhiademi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; zj. Belinda Balluku, Zv. Kryeministër dhe Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë , zj. Mirela Kumbaro,

Ministër i Turizmit dhe Mjedisit; zj. Elva Margariti, Ministër i Kulturës; z. Bledar Çuçi, Ministër i Brendshëm; zj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; zj. Delina Ibrahimaj, Minister i Financave dhe Ekonomisë; zj. Frida Krifca, Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; zj. Milva Ikonimi, Ministër i Shtetit për Standardet e Shërbimeve; zj. Elisa Spiropali, Ministrër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin; zj. Edona Bilali, Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka arritur në konkluzionin se 5 (pesë) Sekretarë të Përgjithshëm të Ministrive përkatëse kanë shkelur pikën 1, të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, pasi kanë vënë në dispozicion faqet zyrtare “facebook” të institucioneve publike që drejtojnë, për të publikuar postime me përmbajtje hashtag, slogane apo thirrje të karakterit elektor/politik, duke promovuar kështu subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet vendorë të datës 14 Maj 2023. Për pjesën tjetër, Komisioneri ka konstatuar se nuk ka shkelje administrative.

4. Me anë të vendimit nr. 442, datë 05.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka urdhëruar fshirjen e menjëhershme nga faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të secilës Ministri, të çdo postimi apo ripostimi në të cilat janë përdorur hashtag me përmbajtje elektorale.
5. Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj zj. Ledina Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; zj. Zerina Bruçi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës; z. Ismail Shehu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë; zj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; zj. Risena Xhaja, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në masën 3 000 (tre mijë) lekë, sikurse parashikohet nga dispozita e nenit 171 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
6. KAS-i caktoi me short z. Koli Bele relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 22, datë 06.05.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më datë 10.05.2023, ora 11:00.
7. Seanca e datës 10.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të Sekretar i Përgjithshëmecialistëve të administratës së KQZ-së. Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive në fjalë, të njoftuar rregullisht nuk u paraqitën në seancën e shqyrtimit.

8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën nr. 22, datë 06.05.2023 të Komisionerit;
- Vendimin nr. 442, datë 05.05.2023 të Komisionerit , “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 350 ID, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe ndaj Zv. Kryeministrit, Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Ministrit të Kulturës, Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrit të Shtetit për Standartet dhe Shërbimet, Ministrit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.
- Denoncimin nr. 350 ID të KRIIK, bashkëlidhur provat materiale fotografike.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

KAS-i konstaton:

1. Kërkesa e Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ ndaj 5 Sekretarëve të Përgjithshëm të Ministrive të sipërcituara, bazuar në denoncimin me nr. 350 ID të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), ka si shkak postimet në faqet zyrtare “Facebook” të Ministrive, të cilat janë përdorur për të publikuar postime me përmbajtje hashtag (#), sloganesh apo thirrjesh të karakterit elektorale/politik, duke promovuar kështu subjektin zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023.
2. Faqet zyrtare të institucioneve publike në rrjetet e ndryshme sociale (facebook, twitter, instagram etj.) bëjnë pjesë në kategorinë “asete”, në kuptim të pikës 2 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, pra ato janë “burime” të institucionit në kuptim të kësaj dispozite. Kjo do të thotë se faqet zyrtare të ministrive në rrjetet e ndryshme sociale të sipërcituara, nuk mund të

përdoren ose të vihet në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.

3. Pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor përcakton se *"...nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia"*. Ky ndalim është konfirmuar edhe nga vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020, i cili në përkufizimin e *"veprimtarive të ndaluara"* ndalonon *"vënien në dispozicion të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme ... për qëllime zgjedhore"*.
4. Ndërkohë, pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor, në të cilën Komisioneri Shtetëror i zgjedhjeve është bazuar në propozimin e masës administrative përcakton sanksionin për shkeljet e kryera *"nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi"*. Personat e ngarkuar me detyra formojnë një listë personash/institucionesh të cilët janë ngarkuar me detyra nominalisht nga Kodi Zgjedhor. Të tillë janë p.sh. vëzhguesit a perfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ (për etikën e punës e të komunikimit), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (për dërgimin e të dhënave nga regjistri për ndarjen e zonave të administrimit zgjedhor, për listën e zgjedhësve etj), zyra e gjendjes civile dhe kryetari i bashkisë (për listën e zgjedhësve), kryetari i bashkisë (për caktimi e qendrave të votimit), Ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile (për nxjerrjen e urdhërave për listat dhe zonant e qendrave të votimit) etj. Fakti se ata dhe detyrat e tyre përcaktohen nga Kodi do të thotë se lista e tyre është e fundme dhe nuk mund të shtohet me ndonjë akt tjetër ligjor ose nënligjor.

Për këtë arsye, KAS çmon se sanksioni për ta nuk mund të vendoset sipas pikës 1 të nenit 171, por sipas pikës 2 të të njëjtit nen.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja 'dh', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës nr. 22, datë 06.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosjen e sanksioneve administrative.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) Lekë ndaj zj. Ledina Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit; zj. Zerina Bruci, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës; z. Ismail Shehu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë; zj. Joana Duro, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe zj. Risena Xhaja, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, bazuar në nenin 171, pika 2, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/20212 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar, mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative Tiranë, Brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij.

Njoftuar palëve të pranishme me shpalljen.

U shpall sot më datë 10.05.2023.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

